



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kryetarja e Komunës

01nr 400-10743

Dt: 25.02.2016

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 11,13 dhe 58 a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L-040, nenit 9 dhe 10 të Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve komunale, Përfundimit 01. Nr. 06-9885-5/4 të miratuar në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve me dt. 24.02.2016, me të cilën është miratuar kërkesa e Organizatës së Pensionistëve të Komunës së Gjakovës, për mbulimin e shpenzimeve të aktiviteteve rreth kësaj organizate me dt: 25.02.2016 e miraton këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Organizatës së Pensionistëve të Komunës së Gjakovës, e evidentuar me nr. 01-400-3220 e dt: 20.01.2016, për mbulimin e shpenzimeve të aktiviteteve rreth kësaj organizate, duke e mbështetur këtë kërkesë me subvencione në vlerë prej 1,500.00€, sipas planit të shpenzimeve të bashkangjitur në kërkesë.
2. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të realizon procesin e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 1,500.00€, nga mjetet e subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe bartjen e këtyre mjeteve në xhirrollogarinë e Organizatës Komunale të Pensionistëve në Gjakovë nr. 1402000001751173 Banka Ekonomike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë .
4. Vendimi iu dërgohet:
 - Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
 - Drejtorisë për Punë të Përgjithshme Administrative
 - Z. Ibrahim Rudi kryetar i Organizatës Komunale të Pensionistëve, Gjakovë
 - Arkivit

Kryetarja e Komunës,

Znj. Mimoza Kusari-Lila

